



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit
P- 063/6
Prishtinë, më 12 mars 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 12 MARS 2009**

Seancën e drejtoi Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Naim Maloku, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 93 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Nuk pati asnjë propozim për amendimin e rendin të ditës.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 26 shkurt 2009.

2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi,
10. Shqyrtimi i Propozimit për emërimin e anëtarit në Komisionin për Ankesa Pronësore dhe
11. Propozimi për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 26 shkurt 2009

Kuvendi miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 26 shkurt 2009.

Deputetja Gjylnaze Syla pati vërejtje teknike në transkript, që u korrigjua sipas kërkesës së saj.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti. Riza Smaka. parashtroi pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, Nenad Rashiq, lidhur me nivelin enorm të papunësisë, si dhe objektivat programore të Ministrisë lidhur me këto çështje.

Ministri Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja, Nerxhivane Dauti, parashtroi pyetje për ministren e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, lidhur me shkaqet e mosprocedimit të Projektligjit për detyrimet në Kuvendin e Kosovës.

Ministria Kelmendi iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputeti, Riza Smaka, parashtroi pyetje për ministrin e Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë, Lutfi Zharku, lidhur me mosthemelimin e Bursës për Letrat Komerciale në Kosovë.

Ministri Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputeti Riza Smaka parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, lidhur me aplikimin e dispozitës së nenit 13. 2. të Ligjit për policinë.

Ministri Pajaziti iu përgjigj pyetjes së deputetit Smaka.

Deputetja, Nurishahe Hulaj, i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Enver Hoxhaj, lidhur me çështjet higjienike në shkollat e Kosovës.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputetja, Nerxhivane Dauti, parashtoi pyetje për ministrin e Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit, Valton Beqiri, lidhur me veprimet e kësaj ministrie për zbatimin e nenit 169.1 dhe 169.2 të Ligjit nr. 2004/45 për mbrojtjen e të drejtave të autorit.

Ministri Beqiri iu përgjigj pyetjes së deputetes Dauti.

Deputetja, Myrvete Pantina, i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me arsyet e pjesëmarrjes së vogël të diasporës në procesin e privatizimit.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetes Pantina.

Deputeti, Ibrahim Makolli, i parashtoi pyetje Kryeministrit, Hashim Thaçi, lidhur me çështjet e hartimit të Projektligjit për sigurimet pensionale.

Kryeministri Thaçi iu përgjigj pyetjes së deputetit Makolli.

Deputetja, Luljeta Shehu, i parashtoi pyetje ministrit të Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, Idriz Vehapi, lidhur me tjetërsimin e tokës bujqësore.

Ministri Vehapi iu përgjigj pyetjes së deputetes Shehu.

Deputetja, Drita Maliqi, i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, Enver Hoxhaj, lidhur me mosregjistrimin e studimeve të doktoratës në fushën e shëndetësisë.

Ministri Hoxhaj iu përgjigj pyetjes së deputetes Maliqi.

Deputeti, Hestet Cakolli, parashtoi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, lidhur me përshtatshmërinë e dispozitave për punësim të stafit civil në polici, në raport me Ligjin për policinë.

Ministri Pajaziti iu përgjigj pyetjes së deputetit Cakolli.

Deputeti, Naim Maloku, i parashtoi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave, Ahmet Shala, lidhur me efektin e afarizmit të ndërmarrjes “Ferronikeli” dhe pagesën e taksave ndaj Kosovës.

Ministri Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit Maloku.

3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryesuesi i seancës, Naim Maloku, ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi që ta prezantojë Raportin.

Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, Bahri Hyseni tha se Komisioni, në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik dhe me anëtarët e organizatave që e kanë

mbështetur punën e Komisionit, ka hartuar planin dhe procedurat e veprimit. Komisioni ka realizuar vizita në: Gjykatën e Qarkut në Pejë, në Gjykatën Komunale në Ferizaj, tek organet drejtuese të enteve ndëshkimore, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, në bazë të të cilave ka hartuar një raport, të cilin ua kemi dërguar të gjithë deputetëve. Për hollësitë e raportit do t'ju njoftojë anëtar i Komisioni, Ibrahim Makolli.

Deputeti Ibrahim Makolli tha se Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, me qëllim të njohjes së drejtpërdrejtë me gjendjen faktike, ka zhvilluar disa takime mbikëqyrëse me institucionet për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale. Për këtë qëllim, Komisioni ka vizituar disa nga institucionet, si Shërbimin Korrektues të Kosovës, Burgun e Dubravës në Istog, Gjykatën e Qarkut në Pejë, Gjykatën Komunale në Ferizaj, si dhe subjektet e tjera të përfshira në zbatimin e këtij ligji.

Gjatë vizitave dhe kontakteve të drejtpërdrejta me zbatuesit e ligjit, Komisioni ka identifikuar probleme të natyrave të ndryshme, të cilat ose e kanë vështirësuar, ose e kanë bërë të pazbatueshëm këtë ligj.

Në bazë të konstatimeve, Komisioni ka nxjerrë këto përfundime:

1. Mangësitë dhe vonesat për nxjerrjen e legjislacionit sekondar nga Ministria e Drejtësisë për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, zvogëlojnë efektivitetin e Ligjit dhe përmasat e zbatimit të tij.
2. Në zvogëlimin e efektivitetit të ligjit kanë ndikuar edhe disa dispozita procedurale të ligjit, të cilat kanë nevojë të ndryshohen dhe të plotësohen.
3. Kapacitetet fizike, profesionale, njerëzore dhe materiale të pamjaftueshme, reflektojnë dukshëm në zbatimin e ligjit në burgje dhe në gjykata.
4. Zbatimi i Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale kërkon sendërtimin e kapaciteteve të veçanta për ekzekutimin e sanksioneve penale në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Prandaj, Komisioni i propozon Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrinë së Drejtësisë këto

R E K O M A N D I M E:

1. Të nxirren të gjitha aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 196.1.
2. Të miratohen rregullat për rendin e brendshëm në institucionet korrektuese, sipas nenit 196.2.
3. Të miratohen rregullat për rendin e brendshëm në Shërbimin Sprovues të Kosovës.
4. Të ngrihet efikasiteti në dorëzim-pranimin e shkresave nga gjykatat te personat e dënuar, me theks të veçantë të atyre shkresave që dërgohen me postë.
5. Të krijohen kushte të domosdoshme për ekzekutimin e dënimeve me gjobë, sepse në të kundërtën dënimet në gjobë po shndërrohen në dënime me burgim dhe ekzekutimi i tyre po paraqet vështirësi edhe për institucionet ndëshkuese.

6. Të ngrihen kapacitetet ekzistuese të kujdesit, të trajtimit shëndetësor në Burgun e Dubravës.
7. Të ngrihen institucione të kujdesit shëndetësor në pajtim të nenit 182 dhe të nenit 185 të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.
8. Të krijohet një sektor i veçantë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe të sektorëve të veçantë në kuadër të gjykatave për ekzekutimin e sanksioneve penale.
9. Të fillojë procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, të atyre dispozitave të cilat pengojnë ose pamundësojnë zbatimin efikas të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale, dhe
10. Ministria e Drejtësisë t'i raportojë një herë në vit Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zbatimin e ligjeve nga fushëveprimi i vet, në pajtim me Rregullën 53 të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar "7+", Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović, si dhe deputetët: Riza Smaka, Gjylnaze Sylja dhe Gani Buçinca, që janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Në fund, ministrja Nekibe Kelmendi, iu përgjigj vërejtjeve të deputetëve të dhëna gjatë këtij debati.

Kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij raporti. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për61,
Kundër..... 0,
Abstenime..... 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi Raportin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me zbatimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Me kërkesë të ministres Nekibe Kelmendi, pika 5 e rendit të ditës u vendos që të shqyrtohet para pikës 4.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta prezantojë Projektligjin për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore.

Ministrja Nekibe Kelmendi tha se fusha e mjekësisë ligjore është në gjendje mjaft delikate sa i përket funksionimit. Vështirësitë janë evidente, kryesisht për shkak të mungesës së legjislacionit përkatës që do të rregullonte fushën e mjekësisë ligjore në përgjithësi. Prandaj,

bazuar në këtë, nëpërmjet këtij projektligji Ministria e Drejtësisë synon që të normohet fusha e mjekësisë ligjore dhe të rregullohet funksionimi i kësaj mjekësie në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në pajtim me parimet e rregullat e shteteve më të zhvilluara evropiane dhe parimet ndërkombëtare. Ky projektligj bën bashkimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe të Zyrës për Persona të Zhdukur dhe të vetë mjekësisë ligjore.

Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë në tërësi çështjet e ekspertimit në fushën e mjekësisë ligjore, siç janë: personat, kufomat, provat materiale, materialet e çështjeve hetimore - gjyqësore, mbetjet mortore të personave të pagjetur e tjera.

Ky projektligj përcakton edhe parimet themelore dhe krijon mekanizma efikas për kryerjen e të gjitha aktiviteteve nga fusha e mjekësisë ligjore për realizimin e të gjitha obligimeve të kërkuara nga organet e hetuesisë dhe të gjyqësorit.

Ky projektligj nuk është shumë voluminoz dhe përmban gjithsej 11 nene, që paraqesin tërë kompozicionin e Projektligjit, i cili është hartuar duke respektuar edhe teknikat juridike të hartimit të legjislacionit.

Ministria e Drejtësisë tani është duke punuar edhe në hartimin e Projektligjit për autopsinë dhe planifikojmë që brenda gjysmës së parë të këtij viti t'ia prezantojmë Qeverisë për miratim dhe në këtë mënyrë të plotësohet infrastruktura ligjore në fushën e mjekësisë ligjore, që do të ndikojë në parandalimin e kryerjes së mjekimeve të pandërgjegjshme.

Miratimi i këtij projektligji është në funksion të kompletimit të infrastrukturës ligjore në sektorin e drejtësisë dhe është me interes të përgjithshëm shoqëror, prandaj kërkoj nga Kuvendi që ta miratojë.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Projektligjin për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Komisionit për Legjislacion e Gjyqësi dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, Vezira Emrush, si dhe deputetët Mimoza Ahmetaj, Naser Rugova, Shkumbin Demaliaj dhe Riza Smaka, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----56,
Kundër-----1,
Abstenime-----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin

për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës, që para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë këtë projektligj.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, **Nenad Rashiq**, tha se kemi një numër të caktuar të huajsh që punojnë në Kosovë, prandaj miratimi i këtij ligji do të përparonte në masë të konsiderueshme këtë rregullativë dhe do të dihej se sipas cilave baza, cilave ligje dhe si mund të punojnë ata në shoqërinë tonë.

Ligji bazohet në nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 41 të Ligjit për të huajt.

Numri i shtetasve të huaj të punësuar në vendin tonë nuk është i vogël dhe ata tani funksionojnë pa rregulla dhe obligime të përcaktuara në mënyrë të qartë. Ato të drejta dhe obligime që është dashur të rregulloheshin në shoqërinë tonë nuk kanë qenë të përdorshme, përkatësisht nuk kanë qenë në fuqi, kështu që ky ligj do të duhej që të gjitha këto t'i rregullojë.

Ky projektligj përmban 27 nene, që përfshihen në 8 kaptina. Projektligji rregullon kushtet për punësimin e shtetasve të huaj, përcakton kushtet e veçanta të punësimit, parimet për lëshimin e lejeve të punës, si dhe të gjitha rregullat e tjera të qenësishme.

Projektligji është i qartë dhe nuk ka kurrfarë implikimesh buxhetore. Do të ishte shumë e rëndësishme që të miratohet, sepse kështu do të vendosnim edhe një nga themelet bazë të shoqërisë sonë, andaj në emër të Ministrisë ju ftoj që të votoni për këtë ligj.

Kryesuesi hapi debatin lidhur me Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: Në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe të Grupit Parlamentar “7+”, Sadik Idriz, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Mimoza Ahmetaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Bujar Bukoshi, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Qamile Morina, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović, në emër të Grupit Parlamentar “Zajedno”, Vezira Emrush, si dhe deputetët: Bahri Hyseni, Shkumbin Demaliaj, Flora Brovina, Naser Rugova, Riza Smaka, Nurishahe Hulaj, Driton Tali, Ibrahim Selmanaj, Gani Buçinca dhe Ardian Gjini, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund, ministri Nenad Rashiq, iu përgjigj vërejtjeve të deputetëve

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----48,
Kundër-----20,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për punësimin e shtetasve të huaj në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi: Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që Projektligjin ta prezantojë para deputetëve të Kuvendit.

Ministri, **Lutfi Zharku**, në emër të Qeverisë tha se gjatë periudhës trevjeçare të aplikimit të këtij ligji, është vërtetuar se ligji aktual ka mjaft mangësi, prandaj edhe nuk aplikohet në mënyrë efektive, kurse shpesh paraqiten edhe situata të padefinuara dhe të paqarta, gjë që vështirëson vendimmarrjen e institucioneve tona, kurse në raste të caktuara politikave tona programore nuk mund t'i zbatojmë për shkak të kufizimeve aktuale ligjore.

Ndryshimet dhe plotësimet në këtë projektligj fillojnë me shtimin e veprimtarisë së përpunimit të derivateve të naftës, si nevojë e biznesit dhe heqjes së veprimtarisë të transportit nga ky ligj, pasi që kjo fushë është e rregulluar me Ligjin për transportin e mallrave të rrezikshme.

Plotësimet e ligjit vazhdojnë me heqjen e kufizimeve të panevojshme ligjore me rastin e emërimit të Këshillit të Naftës, përcaktimit të mandatit për të gjithë anëtarët: definimit të qartë të kompetencave, të përgjegjësisë, raportimit dhe procedurës së shkarkimit të anëtarëve të tij, si dhe të ndalimit të emërimit në Këshill të zyrtarëve, të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës me procedurë disiplinore.

Risi e propozuar është edhe heqja e marrjes së vendimit për licencim nga ana e Këshillit me procedurë të votimit. Sa u përket standardeve të naftës, është propozuar që ato të përcaktohen me anë të akteve nënligjore, në përputhshmëri me zhvillimin ekonomik të vendit dhe të standardeve të BE-së.

Me propozimet e reja përcaktohet në mënyrë decizive ndalimi i përdorimit të mjeteve matëse të pakalibruara gjatë shitjes së naftës dhe të derivateve të saj, si dhe shitja me shumicë personave të pa licencuar.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar inspektimit të tregut, duke propozuar fuqizimin e kompetencave të Inspektoratit, si dhe është bërë ripërcaktimi i gjobave, duke marrë parasysh llojin e shkeljes, si dhe veprimtarinë e shitjes me shumicë apo me pakicë.

Në fund, ministri Zharku i ftoi deputetët ta miratojnë Projektligjin, në parim.

Kryetari hapi debatin lidhur me këtë projektligj.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Komisionit për Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së, Haki Shatri, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjona, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ethem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, si dhe deputetët Driton Tali dhe Gjylnaze Sylja, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte , si vijon.

Për-----54,
Kundër-----1,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë.

Kuvendi ngarkoi: Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Legjislacion dhe Gjqësi, Komisionin për Komunitete dhe Komisionin për Integritet Evropian, që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7 . Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/17 për mbrojtjen e konsumatorëve

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për58,
Kundër..... 1,
Abstenime..... 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

Kryetari njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka shqyrtuar Projektligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime. Ai ftoi përfaqësuesin e Komisionit që ta arsyetojë raportin.

Kryetari i komisionit funksional, Lulzim Zeneli, tha se në emër të Komisionit Parlamentar për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor propozoj që ky projektligj të shtyhet për seancën tjetër të radhës, me arsyetimin se Projektligji ka disa mangësi për të cilat duhet një konsultim me anëtarët e Komisionit dhe me Qeverinë.

Kryetari hodhi në votim propozimin e Lulzim Zenelit. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për54,
Kundër..... 5,
Abstenime..... 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, vendosi që shqyrtimi i dytë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes të shtyhet për seancën tjetër.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, ka shqyrtuar Projektligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3,4, 5,6,7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për39,
Kundër.....27,
Abstenime..... 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave në bashkëpronësi.

10. Shqyrtimi i Propozimit për emërimin e anëtarit në Komisionin për Kërkesa Pronësore

Kryetari i informoi deputetët me rekomandimin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me propozimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për emërimin e një anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore.

Ai ftoi përfaqësuesin e Komisionit që ta arsyetojë raportin.

Kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi z. **Bahri Hyseni**, tha se Komisioni, në bazë të neneve 10 dhe 11 të Ligjit 03L/079 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për zgjedhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, në pajtim me përfundimet e Kryesisë së Kuvendit, të datës 3 mars 2009, ka shqyrtuar propozimin e Gjykatës Supreme të Kosovës për emërimin e z. Adem Vokshi, anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Komisioni, pas shqyrtimit të dokumentacionit, ka konstatuar se kandidati i propozuar i plotëson të gjitha kushtet e parapara me ligj për t'u emëruar anëtar të këtij komisioni.

Kryetari hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Legjislacion. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për60,
Kundër..... 1,
Abstenime..... 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Adem Vokshi, emërohet anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore.
2. Mandati i anëtarit të Komisionit për Kërkesa Pronësore zgjat një (1) vit.

9. Propozimi për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media

Kryetari i njoftoi deputetët me propozimin e Grupit Parlamentare SLS-së për zëvendësimin e Një anëtari në Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media.

Kuvendi, me propozim të Grupit Parlamentar të SLS-së, emëroi deputetin Dragan Dimiq, anëtar të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, në vend të deputetes, Radmilla Vujoviq.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 18:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**